



Republika e Kosovës- Republika Kosova- Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Regulativni Autoritet Železnica

Railway Regulatory Authority



Institucioni : Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall :

KONKURS I BRENDSHËM

Titulli i punës: Zyrtar i Lartë për Treg (Monitorues i Rregullimit të Tregut)

Nr.ref. RN00003238

Kategoria funksionale : Niveli Profesional

Koeficienti : 8

Lloji i pozitës : I karrierës

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat

Vendi i punës : Prishtinë

Mbikëqyrës: Drejtori i Departamentit për Rregullim të Tregut

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i mbështetjes profesionale përmes analizave, këshillave dhe ekspertizave me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara të njësive organizative, pa mbikëqyrje të afërt në punë.

Detyrat Kryesore

- Monitoron në përcaktimin e procedurave për procesin që ka të bëjë me sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë;
- Monitoron në sigurimin që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi I vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese;
- Monitoron rregullimin e tregut në lokalet e menaxherëve të Infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore;
- Mbikëqyr në pajtueshmëri në sigurimin që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese;
- Ndihmon në përcaktimin e rregullave për shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor, adresimin e ankesave të konsumatorëve dhe sigurimin e mbrojtjes së konsumatoreve;
- Ndihmon në krijimin e procedurave për dhënien e kontributit për politikat të cilat ofrojnë zhvillim të qëndrueshëm, shërbime mjedisore të transportit dhe kontribut në zbatimin e tij.
- Monitorimi i tërë tregut hekurudhor në Kosovë;

- Kryerja e monitorimit dhe dhënja e kontributit për të zhvilluar sistem të integruar të transportit të udhëtarëve dhe mallrave;
- Te kryej punë dhe detyra tjera me ndërgjegjeje dhe përgjegjësi te cilat caktohen nga mbikëqyrësi.

Shkathtësitë e kërkuara

- Diplomë Universitare nga fushat si Fakulteti Ekonomik, Juridik, Inxhinieri
- 3 vite përvojë pune profesionale
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e administratës

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurrenca.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësitë e barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Shpallur më 22.05.2018 deri 29.05.2018 ora 16:00